



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS
KRYETARI I KOMUNËS



Raport për debatin e parë me qytetarë për periudhën Janar-Qershor 2020

Të nderuar qytetarë të Komunës së Malishevës,

sikur çdo vit tjetër, edhe në këtë vit, unë si kryetar i komunës dhe e tërë qeveria komunale, jemi munduar dhe kemi bërë përpjekje maksimale për realizimin e objektivave të përcaktuara dhe të planifikimeve, të cilat konsideroj se deri diku kemi arritur ti realizojmë, edhe pse në gjysmën e parë të këtij viti, jo vetëm ne se komunë, por i tërë vendi, jemi përballur me pandeminë e COVID-19, e cila ka ndikuar drejtpërdrejtë në të gjitha sferat e jetës, e natyrisht edhe në punën e institucionit të komunës.

Pavarësisht situatës së krijuar nga pandemia, ne, krahas menaxhimit të kësaj situatë të krijuar, në të njëjtën kohë jemi marrë edhe me realizimin e objektivave, përkatësisht me menaxhimin e punëve tjera, duke filluar nga ofrimi i shërbimeve për qytetarët, deri tek realizimi i investimeve kapitale.

Pjesën më të madhe të kohës gjatë këtij gjysmë viti, e ka marrë menaxhimi i gjendjes emergjente në shëndetësi për shkak të pandemisë COVID-19, ku ne si komunë, nga dita e parë i kemi marrë të gjitha masat e nevojshme, sipas obligimeve ligjore që i kemi në nivelin lokal. Është formuar shtabi emergjent komunal, është aktivizuar qendra operative emergjente lokale, dhe janë marrë të gjitha masat tjera për menaxhimin e kësaj situatë, bazuar në Planin e Reagimit Kombëtar.









Krahas menaxhimit të sëmundjes, brenda kapaciteteve dhe obligimeve, si nivel lokal, ne jemi marrë edhe me efektet anësore të pandemisë, duke ju ofruar shërbimet e nevojshme për të gjithë qytetarët e Komunës së Malishevës, përkatësisht ju është ofruar mbështetje në furnizim me ushqime dhe barna për të gjitha rastet në nevojë.

Në menaxhimin e situatës, kanë qenë të aktivizuara të gjitha drejtoritë dhe shërbimet përkatëse komunale, ku së bashku edhe me shërbimin shëndetësor dhe me organet e sigurisë, jemi marrë me situatën, me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të qytetarëve tanë.

Shtabi komunal emergjent, ka qenë në dispozicion dhe është ende, 24 orë në ditë, dhe gjatë kësaj kohe në vazhdimësi mbikëqyrret situata, dhe mbikëqyrren të gjitha rastet e prekura me COVID-19, ku në vazhdimësi janë mbajtur dhe mbahen kontakte me pacientët dhe rastet e kontaktit. Të gjitha rastet e prekura apo të dyshuara, janë izoluar, ku krahas ofrimit të shërbimit të nevojshëm shëndetësor, këtyre rasteve u janë ofruar shërbimet tjera sipas nevojës, si furnizimi me barna, ushqime dhe transportimin e tyre, sipas gjendjes së krijuar.

Krahas këtyre shërbimeve, gjithashtu kemi bërë edhe dezinfektimin e objekteve të banimit, në të gjitha rastet e evidentuara me COVID-19, po ashtu kemi bërë edhe dezinfektimin e hapësirave tjera publike dhe private, sipas nevojës, përfshi të gjitha objektet e institucioneve.

Në vazhdimësi, janë bërë inspektime në të gjitha subjektet afariste, sipas vendimeve dhe udhëzimeve të dhëna nga niveli qendror. Është mbikëqyrur në përpikëri zbatimi i masave parandaluese të përhapjes së COVID-19.

Në menaxhimin e kësaj shtate, kanë qenë të angazhuar të gjithë sektorët, duke filluar nga zyra e kryetarit, drejtoritë dhe sektorët tjerë. Po ashtu, të angazhuar në menaxhim të situatës dhe në ofrim të shërbimeve të nevojshme, kanë qenë i tërë sektori i shëndetësisë, përkatësisht QKMF-ja dhe të gjitha QMF-të dhe AMF-të, pastaj Policia e Kosovës, që gjithashtu ka luajtur rol kyç në menaxhimin e situatës, pa i anashkaluar edhe të gjithë kryetarët dhe kryesitë e fshatrave të Komunës së Malishevës.

Të nderuar qytetarë, para të se të kaloj në prezantimin e punëve dhe obligimeve tjera, më lejoni që ti falënderoj për punën dhe angazhimin e tyre në menaxhimin e kësaj shtate të gjithë ata që kanë qenë të angazhuar drejtpërdrejtë, duke filluar nga Shtabi Emergjent Komunal dhe Qendrën Operative Emergjente Lokale, për angazhimin e tyre 24 orë në ditë, të gjithë punëtorët shëndetësorë, Policinë e Kosovës, Inspektoratin Komunal, të gjitha shërbimet komunale, njësinë për menaxhimin e mbeturinave, të ujërave, postën dhe telekomin, të gjithë ofruesit e shërbimeve të internetit dhe kabllorikut, të gjithë mësimdhënësit për angazhimin e tyre në mësimin online, të gjithë kryetarët e fshatrave për angazhimin e tyre maksimal në shërbim të banorëve të vendbanimeve të tyre, si dhe të gjithë qytetarët e Komunës së Malishevës, për maturinë dhe kulturën e tyre të treguar në këtë shtatë. Po ashtu, në mënyrë të veçantë i falënderoj të gjithë donatorët, që gjatë kësaj periudhe na kanë ndihmuar si në ushqime, ashtu edhe me mjete mbrojtëse.

Krahas kësaj pandemie, ne si komunë përballemi edhe me endeminë e etheve hemorragjike krime kongo (EHKK), ku për këtë qëllim gjithashtu kemi formuar shtabin komunal që merret me zbatimin e strategjisë nacionale për luftimin dhe parandalimin e EHKK. Sfidë për ne ka qenë mos realizimi i repelimit të kafshëve, si masa që konsiderohet më efektive në luftimin e EHKK, por që kjo nuk varet nga komuna, por nga niveli qendrorë. Edhe këtë vit, është duke u zhvilluar fushata e dezinfektimit të zonave endemike, varësisht nga situata në terren, janë duke u trajtuar zonat që konsiderohen më problematike, përderisa nga organet tona, në vazhdimësi është duke u mbikëqyrur edhe kjo situatë.

Edhe pse jemi përballur me një situatë të rëndë, e cila ka ndikuar në përgjithësi në jetesën tonë, e sigurisht edhe në punën e institucioneve, Komuna e Malishevës, ka vazhduar që në të njëjtën kohë të merret me implementimin e obligimeve tjera, e në veçanti në realizimin e projekteve të planifikuara.

Gjatë këtyre gjashtë muajve, kemi vazhduar me implementimin e projekteve dyvjeçare dhe me projektet tjera të planifikuara për këtë vit kalendarik.

Investimet, bazuar edhe në buxhetin e miratuar në Kuvendin e Komunës, kanë vazhduar në të gjithë sektorët, si në infrastrukturën rrugore, trotuare, kanalizime, ujësjellës, në ndërtimin e shkollave, fushave sportive, subvencione, fillimi i procedurave për ndarjen e 200 bursave për studentë dhe projekte tjera me rëndësi.

Po ashtu nuk janë lënë anash as sektorët tjerë, dhe në vijim të vitit, pavarësisht situatave të krijuara, do të realizojmë të gjitha planifikimet.

Në administratën komunale janë ofruar të gjitha shërbimet e nevojshme për qytetarët dhe gjatë këtij gjysmë viti, nuk është regjistruar asnjë ankesë në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Inspektorati i komunës sonë, edhe pse në një situatë jo të zakonshme, ka vazhduar me kryerjen e obligimeve të tyre në mbikëqyrjen e vazhdueshme në të gjithë sektorët që i ka në përgjegjësinë e tyre.

Në sektorin e kulturës, rinisë dhe sportit, komuna ka bërë shpalljen për subvencionimin e OJQ-ve në këta sektorë, ndërsa janë zhvilluar edhe aktivitetet e parapara, sidomos në shënimin e datave të caktuara, siç janë 17 Shkurti, Epopeja e UÇK-së dhe Dita e Çlirimit dhe e Dëshmorëve të Komunës së Malishevës (kjo e fundit me aktivitete të reduktuara për shkak të situatës me COVID-19).

Edhe sektori i arsimit dhe edukimit ka qenë në situatë jo të mirë për shkak të pandemisë, por megjithatë është arritur të zhvillohet mësimi në distancë. Gjatë këtyre gjashtë muajve, është përfunduar objekti i ri i shkollës në Lladrovç, pastaj ka filluar ndërtimi i fushave sportive në Lladrovç, Bardh, Vërmicë, Gollubovç, Carrallukë dhe kjo do të vazhdohet edhe në shkollat tjera

sipas planifikimeve. Gjithashtu janë rregulluar, apo janë në rregullim e sipër edhe hapësirat e jashtme dhe të brendshme në disa shkolla, si në Mleqan, Lladrovç, Carrallukë, dhe të tjera. Janë duke u ndërtuar edhe katër objekte të reja shkollore, në Malishevë, Dragobil, Gurbardh, si dhe kanë rifilluar punimet në shkollën në Panorc. Po ashtu, janë duke u ndërtuar edhe katër salla të sportit, në Astrazup dhe Malishevë, dhe krahas objekteve të reja të shkollave po ndërtohen edhe sallat e sportit në shkollat në Malishevë dhe Dragobil.

Pa dyshim se investimet në infrastrukturën tjetër nëpër vendbanime, është më me interes për të gjithë, prandaj në vazhdim do të paraqesim edhe në fushat tjera, të cilat lidhen me mirëqenien dhe rritjen e cilësisë së jetesës për qytetarët.

Këtë vit kemi vazhduar dhe jemi në përfundim e sipër të ndërtimit të objektit të urgjencës pranë QKMF-së në Malishevë, i cila ka rëndësi të jashtëzakonshme në rritjen e cilësisë së ofrimit të shërbimeve shëndetësore.

Po ashtu, jemi duke hapur dhe rregulluar rrugë të reja në qytet dhe në fshatrat e komunës sonë, pastaj trotuare, kanalizime dhe ujësjellës të rinj.

Edhe shërbimet publike, janë duke vazhduar me punën e tyre, në ofrimin e shërbimeve sa më të mira dhe për një ambient sa më të pastër, pastaj mirëmbajtje e ndriçimit publik dhe ndriçim të ri publik.

Po ashtu edhe shpenzimet e shërbimit të varrimit do të vazhdojnë të mbulohen nga komuna.

Buxheti i planifikuar dhe i miratuar në Kuvendin komunal për të gjitha kategoritë ekonomike për vitin fiskal 2020, është në vlerë prej 15,583,802.00 euro.

Buxheti deri në këtë periudhë, për të gjitha kategoritë ekonomike është shpenzuar në vlerë prej 5,471,889.87 euro ose shprehur në përqindje 35.11%.

Për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19, me vendim të Kuvendit komunal janë ndarë 150,000.00 EUR, prej të cilave janë shpenzuar rreth 65,000.00 euro.

Në vazhdim, edhe përmes fotografive, do ti prezantojmë disa nga projektet që aktualisht janë duke u realizuar në Komunën e Malishevës.

SHKOLLA ME SALLËN E SPORTIT NË MALISHEVË



SALLA E SPORTIT NË SHFMU “IBRAHIM MAZREKU” NË MALISHEVË



SHKOLLA ME SALLË TË SPORTIT NË DRAGOBIL



SHKOLLA NË GURBARDH



SHKOLLA NË PANORC



SALLA E SPORTIT NË ASTRAZUP



FUSHA SPORTIVE NË BARDH



OBJEKTI I RI I SHKOLLËS NË LLADROVC



OBORRI I SHKOLLËS NË LLADROVC



FUSHA E SPORTIT NË LLADROVC



FUSHA E SPORTIT NË GOLLUBOVCI



FUSHA E SPORTIT NË VËRMICË



OBORRI I SHKOLLËS NË GOLLUBOVÇ



MEREMTIMI I SHKOLLËS DHE RREGULLIMI I OBORRIT TË SHKOLLËS NË MLEQAN



OBORRI I SHKOLLËS DHE FUSHA E SPORTIT NË CARRALLUKË



OBJEKTI I URGJENCËS NË MALISHEVË



INKUBATORI I BIZNESIT NË MALISHEVË



RRUGËT NË MALISHEVË





RRUGËT NË TEMEQINË



RRUGËT NË NGUCAT DHE RRUGA NGUCAT-JAVOR



RRUGËT NË BARDH





RRUGËT ME KUBA NË KËRVASARI





RRUGA RUD-SFERKË



FILLIMI I NDËRTIMIT TË RRUGËVE NË LLAPÇEVË



RRUGË NË BELLANICË



TROTUARI NË LUBIZHDË



TROTUARI NË GURBARDH



TROTUARI MLEQAN-PPLOQICË



TORUTUARI NË VËRMICË



TROTUARI NË PAGARUSHË



UJËSJELLËSI NË JANQISHT



KANALIZIME



DEZINSEKTIMI KUNDËR RRIQRAVE



DEZINFEKTIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE, KUNDËR COVID-19



Ka edhe shumë e shumë projekte dhe punë tjera të cilat janë në realizim e sipër.....

Të nderuar qytetar, për çdo gjë që keni interesim, ju lutem që përmes e-mailit zyrtar të komunës në: komuna.malisheve@rks-gov.net, të bëni pyetje, të komentoni punimet apo çfarëdo që keni nevojë, të na shkruani dhe ne do të ju përgjigjemi të gjithëve.

Për hir të transparencës, të gjitha pyetjet, komentet dhe përgjigjet, do të bëhen publike.

Prandaj, brenda një jave, nga data 01.07.2020-08.07.2020, na shkruani në komuna.malisheve@rks-gov.net.

Faleminderit.

Kryetari i Komunës së Malishevës

Ragip Begaj